

**UDHËZIM**  
**Nr. 24, datë 4.8.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.5.2021, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 12, pika 4 dhe të nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në kreun XVII, “Procedurat e marrjes në punë të personelit drejtues të ofruesit të AFP-së”, neni, 69, pika 2, shkronja “a”, ndryshon si më poshtë:

“a) të ketë diplomë të studimeve universitare master shkencor ose të barasvlershëm me të;”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Delina Ibrahimaj**